



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **138**

Prishtinë, më 12.2.2014, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT (DËGJIMIT PUBLIK)

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci.

Munguan : Daut Haradinaj dhe Boban Todoroviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen (dëgjimin publik) e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA

Kryetari Nait Hasani sqaroi fillimisht rreth fazës përgatitore në komision për ti dalë në ndihmë shoqërisë rreth kësaj teme të politizuar në rrugë, ndaj ky ligj do të trajtoj problemin e zhurmës e jo diçka tjetër, përshëndeti të ftuarit dhe **Ministrin Dardan Gashi** si përfaqësues i projektligjit të cilit në fillim ja dha fjalën. Ministri falënderoi dhe sqaroi se ky ligj nuk do të mirët me bashkësitë fetare por me zhurmën që krijohet nga burimet e ndryshme, si dhe jo specifikisht nga objektet fetare por nga pajisjet akustike të tyre, për çka edhe është krijuar tensionimi rreth projektligjit në fjalë, që do të thotë se në asnjë mënyrë nuk është menduar për ndalimet e këtyre burimeve, në fund fundit, vazhdoi ai, ky nuk është ligj i parë në botë por është një ligj që ka parasysh ligjet në vendet islame lidhur me këtë çështje (Arabia Saudite, India, Egjipti, Turqia etj), ndaj neve na mbetet të bashkëpunojmë dhe harmonizojmë qëndrimet mes vëdi rreth pjesës akustike të këtyre objekteve duke mos politizuar dhe mos ndjellur ndasi për çka edhe jemi dakorduar me myftiun dhe tjerët, ngase ka nevojë për rregullim. Ai kërkoj të ndalohen ndasit që janë krijuar dhe kërkoi bashkëpunim.

Sabri Bajgora, kryeimami i Kosovës (BIK), potencoi se ky projektligj ka krijuar pompozitet rreth kinse ndalimit të ezanit, ndaj sqaroi se edhe bashkësia islame e ka të qartë se ligji bënë fjalë vetëm për zvogëlimin e zërit nëpër altoparlantë të objekteve të ndryshe dhe ato fetare (qarkorja është dërguar nga BIK para 7-8 vite nëpër disa qytete të Kosovës që volumi i zërit të jetë pak më

e vogël gjatë jasisë dhe sabahit), ndaj për shkak se feja është diçka shpirtërore që secili merr atë çka i nevojitet dhe në favor të harmonizimit të qëndrimeve ai parashtrroi vërejtjet si vijon :

Amendamenti 1

Neni 2.7, pas fjalës “riteve” të shtohet **“fetare dhe”**.

Amendamenti 2

Neni 4.2, pas fjalës “akustike” të fshihet **“të objekteve fetare si dhe pajisje tjera”**.

Amir Ahmeti – deputet, falënderoi për organizimin e dëgjimit publik dhe tha se prapë u dëgjuan akuzat e njëjta nga ministri i cili sipas tij nuk din të flas me gjuhë juridike (kryetari reagoi për kujdes në shprehje), ky propozim ligj sipas tij, si i tillë shkelë drejtat fetare dhe për të kanë votuar minimumi i nevojshëm i deputetëve sa për të kaluar në leximin e parë (vetëm 38 deputet). Vet interesimi i ministrit për ndryshime pas vizitës në BIK, vazhdoi, tregon se projekti nuk është perfekt. Ai përfaqësoi mendimin e tij i cili konsistoi në atë se ky ligj është i nevojshëm por zhurma (ezani dhe kambanat) nuk krijohet nga objektet fetare ngase zërimi nga ato objekte janë sinjalizime të cilat nuk jehojnë pandërprerë por vetëm disa minuta (gjatë diskutimit të këtij deputeti, ministri ndërhynte që i njëjti të fokusohet e jo të mbaj “ligjërrata”). Deputeti në fjalë vazhdoi edhe më tutje duke dhënë arsyetimet e tij të bazuara në dispozitat ndërkombëtare, traditën tonë etj duke kërkuar harmonizim dhe bashkëpunim në këtë drejtim për eliminimin e pengesave në projektligj ngase ka mangësi. Nëse në leximin e dytë hiqen fjalët tek Neni 4.2 “objektet fetare” do të jemi në rregull dhe nuk ka nevojë të gjuhemi me fjalë sikurse që tha ministri, përfundoi.

Bahri Sejdiu kryetar i bashkësisë islame në Prishtinë, gjithashtu apeloj që thirret fetare mos të radhiten dhe trajtohen në nivelin e zhurmës sikurse para do kohe që u trajtua çështja e shamisë nëpër shkolla (kur shamia u krahasua me disa gjëra shumë të ulëta të shoqërisë). Nëpër 25 xhami sa i ka Prishtina, bashkësia islame pajtohet që të kemi një aparaturë më moderne qendrore që rregullon thirret fetare por jo ezani të trajtohet si zhurmë.

Valbona Puka (nga Avokati i popullit) tha se parimisht përkrahin projektligjin dhe nuk kanë vërejtje, mirëpo shteti është ai që balancon interesat e ndryshme të shoqërisë dhe dispozitave evropiane, për çka ishte i mendimit edhe **Agron Bektashi** nga REC (qendra rajonale për mjedis).

Mirjeta Goli (Instituti për politika zhvillimore) kishte pyetje për ministrin rreth qëllimit të këtij ligji, për çka ministri kishte vërejtje se nuk gjendet në konferencë për shtyp, por megjithatë u pajtua se fjala zhurmë ka konotacion negativë, mirëpo në këtë rast kjo fjalë është term teknik dhe për këtë arsye MMPH është i interesuar të kontribuoi për mospolitizim, në shqyrtimin e mëtejshëm në komisionin parlamentar. Ne në MMPH nuk kemi gabuar, por pse jemi keqkuptuar, janë disa këtu që kanë kontribuar politizimit, përfundoi.

Salih Morina theksoi se ky komision fatkeqësisht ballafaqohet ndonjëherë me disa projektligje që nuk ishte dashur të janë në kompetencë të tij ngase i takojnë fushës tjetër, sidomos zhurma e cila si fenomen nuk i takon çështjes fetare, ai sugjeroi që politizimet që janë krijuar të eliminohen duke rregulluar Nenin 4.2 dhe duke lënë mundësinë e rregullimit të zërimeve me decibel sipas UA, por fillimisht të japin të gjithë kontributin e tyre dhe të arrihet uniteti në mes përfaqësuesve që kanë mendime të ndryshme, duke pasur parasysh standardet nga vendet tjera islamike por edhe krishtere etj.

Enis Kervan-deputet- sugjeroi ndryshime në Nenin 2 dhe Nenin 4 dhe shtoi se ky ligj i nevojitet Kosovës por jo si ngarkesë, ngase pajisjet akustike fetare nuk janë burime të zhurmës, prandaj kjo çështje duhet të rregullohet me ligjin për liritë fetare ose me UA, sugjeroi modelin e legjislacionit të Turqisë ku është rregulluar kjo çështje me ligjet për mjedisin por edhe me ligjin për liritë fetare, ku pajisjet akustike nga objektet fetare nuk konsiderohen burime të zhurmës.

Faton Topalli përfaqësoi mendimin e grupit politik nga rrjedhë sipas së cilës tingulli nga objektet fetare paraqet identitet kulturor dhe assesi nuk është zhurmë, çka edhe ligji nuk e trajton

si të tillë. Pasi që ligjet e perëndimit rregullojnë tingullin, edhe ne pajtohemi të bëhet kjo, poashtu propozoi të ndryshohet titulli i ligjit : **Ligji për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore** dhe të hiqen fjalët “**në objektet fetare**” të Neni 4.2 dhe aty ku ekzistojnë në projektligj, gjithashtu të **Neni 15.2** për vlerat kufitare të zhurmës, ligji nuk i përcakton këto por thotë se këtë vlerë e përcakton ministri, por kjo duhet me u rregullua nga Kuvendi e jo nga ministri, gjithashtu është problemi edhe sa i përket kohës 15.4, ndaj komisioni duhet të veproi rreth kohës së paraparë për ndalimin e zhurmës prej 22 deri 7 të mëngjesit pa fyerje të askujt, përfundoi.

Rasim Demiri përshëndeti të pranishmit dhe tha se për këtë projektligj grupi 6+ mendon se duhet të nisemi nga bisedat e përbashkëta dhe unike ngase si tha “në takimin e sotëm unë dëgjoj disa mendime ndryshe nga disa përfaqësues të partive sesa qysh kanë folur në leximin e parë”, sidomos në bashkësinë islame që kishte komisioni takimin me myftiun Naim Tërnavë, ku mendimi unik ishte që duhet të rregullohet Neni 4.2 ose të hiqet fjala “objektet fetre” ngase tingujt nga objektet fetare nuk mund të krahasohen me prodhues të zhurmës siç janë trafiku etj. Ai shpresoj se një ligj për religjionet do të zgjidhte problemet më mirë si dhe do të gjendet uniteti ngase liria fetare është e garantuar edhe me Kushtetutë.

Ramiz Lladrovci përshëndeti të pranishmit, sidomos diskutimin e Sabri Bajgorës i cili sipas tij shtroi çështjen si duhet dhe jashtëzakonisht korrekt, gjithashtu shprehu dëshirën për gjuhë të përbashkët rreth Nenit 4.2, ndërkaq deputeti Amir Ahmeti sipas tij është ngacmuar nga disa media duke dhënë konotacion politik sepse askush nuk është kundër ezanit apo këmbanave dhe askush nuk i ka dhënë atë ngjyrim që ja kanë dhënë mediat. Definicioni “zhurmë” mund të rregullohet gjatë amendamentimit të projektligjit, nëse e gjejmë ndonjë përkufizim më të mirë, tha në fund.

Sevdije Lama konsideroj se termi zhurmë assesi nuk mund të trajtohet sa i përket objekteve fetare ngase ezani dhe këmbanat janë thirje për falje, ky është edhe qëndrim i GP KKR, gjithashtu ato janë diçka shpirtërore, ndaj nuk janë burim të zhurmës. Ajo shtoi dhe përshëndeti kryetarin e bashkësisë islame i cili në ditën e takimit me komisionin u përgjigj se e ka lëshua në mëngjes dhe mbrëmje qarkoren e nivelit të zërit i cili vetvetiu e ka rregulluar, pa pasur nevojë për ligj.

Afërdita Berisha shprehu mendimin se Kuvendi Kosovës nuk ka miratuar projektligjin kundër ezanit si është komentuar nga disa dhe është bërë marketing politik, ndaj ky term është teknik i cili duhet të rregullohet dhe ezani nuk do të trajtohet si zhurmë, ajo u pajtua me përfaqësuesen e avokatit të popullit rreth balancimit të interesave të ndryshme dhe tejkalimin e keqkuptimeve.

Amir Ahmeti debati sipas tij është i mirëfillët mirëpo shprehu habinë me qëndrimin e ministrit ngase të gjithë deputetët këtu e than një gjë (pjesa që duhet të hiqet nga ligji), ndërsa ai tjetër diçka (reaguan disa deputet : folë për vedi, jo për tjerët), ai tha se ministri nuk po pajtohet me qëndrimet e mia politike, ndaj dalim dikun tjetër e debatojmë nëse dëshiron, ngase këtu flasim vetëm juridikisht. **Nait Hasani** : ti e ke sjellë amendamentin. **Amir Ahmeti** : pajtohem me deputetët që të rregullohen decibelat e zërit me UA ose tjetër mënyrë, por jo me këtë ligj. Unë jam në të njëjtin vi me deputetët (Sevdijen, Rasimin, Fatonin etj) por nuk po di çka po i pengoj ministrit me qëndrimin tim (politik).

Dardan Gashi falënderoj dhe tha të dakordohemi për diçka : substanca e ligjit nuk është diskutabile, por edhe bashkësia islame vetë është e interesuar mu rregullua diqysh ky problem (zërimi), ngase është çështje teknike qysh mu rregullua ky problem por jo tani në këtë tryezë, esenca që termi zhurmë a duhet të përfshihet në këtë çështje, në këtë rast është term teknik por në esencë ka dal si kualifikim-diçka negative OK, por jemi dakord me ndryshua këtë term, ata që po dojnë me politizu le të vazhdojnë por nuk kanë me fitua, por kanë me fitua ata që po dojnë me rregullua këtë çështje, që jemi gjithë na tjerët përveç....neise spo përmendi.

Nait Hasani : nëse nuk ka dikush tjetër, ju njoftoi se Komisioni do të punoi sipas rregullores që e ka dhe Kushtetutën e cila i garanton drejtat e secilit, dhe do të bëjë një vizitë në Stamboll për të parë si është rregulluar kjo çështje atje, pastaj shihemi dhe ju njoftojmë për takimet e radhës.

SHTESË :

Pas mbajtjes së dëgjimit publik, është lajmëruar Kisha Katolike me imejll përmes Don Jeton Thaqi zëvendës kancelar, duke arsyetuar mosardhjen dhe duke prezantuar vërejtjet me shkrim si vijon :

- **mbështesim projektligjin në parim dhe gjitha ato ligje që respektojnë standardet evropiane,**
- **objektet tona fetare të kultit kanë kampanat të cilat vehen në funksion në kohën të cilën projektligji e përcakton si ditë (prej orës 7 mëngjes deri 19 mbrëmje), me përjashtim të festës së Krishtlindjes dhe Pashkëve, që vehen në funksion edhe në mesnatë,**
- **sa i përket Neni 2.7 kërkojmë që brenda këtyre festave të llogaritet edhe dita e diele që për kishën dhe besimtarët tanë janë ditë feste, por gjithnjë duke llogaritur kohën që projektligji përcakton si ditë (7-19),**
- **duhet të rishikohet Neni 4.1 dhe 4.2 ku padrejtësisht janë konsideruar si burim zhurme pajisjet e objekteve fetare, gjithashtu është i pakuptimtë përkufizimi i “zhurmës” ngase nuk duhet ti atribuohet pajisjeve akustike të objekteve fetare një cilësim i tillë. Këto mund të quhen zëra, tinguj me një terminologji më të përshtatshme pasi janë çështje shpirtërore. Ndaj propozojmë që vetëm në rastin kur këto pajisje do të kalonin përkufizimin e paraparë me ligj, atëherë ky tejkalim apo mosrespektim i ligjit mund të konsiderohet si zhurmë apo potencialisht burim zhurme.**

Mbledhja përfundoi në orën 14,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani**